



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VAU DEJËS
DREJTORIA E PYJEVE, TURIZMIT KULTURES DHE MJEDISIT
Sektori i Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave

Nr. _____ prot.

Vau Dejës, më ____ . ____ .2020

RELACION

Për ndërtime të përkohshme “për qëndër stani e rrethuar, ngrehinë banimi për barinjë dhe stafin” .

Drejtuar : Këshillit Bashkiak Vau i Dejës

Të nderuar këshilltarë,

Administrimi i fondit pyjor dhe kullor në territorin e Bashkisë Vau u Dejës, është një ndër funksionet e Bashkisë, i përcaktuar në nenin 27 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ku në pikën 5 të këtij neni përcaktohet: **Funksionet e Bashkive në fushën e bujqësisë, zhvillimit rural, pyjeve dhe kullotave publike, natyrës dhe biodiversitetit:** Bashkitë janë përgjegjëse për kryerjen e këtyre funksioneve pika 5. *Administrimin e fondit pyjor dhe kullor publik, sipas legjislacionit në fuqi.*

Ligji bazë mbi të cilin kryhet administrimi i fondit kullor është ligji nr. 9693 dt 19.03.2007, i ndryshuar “Për fondin kullor publik” neni 17, udhëzimi i Ministrit të mjedisit nr. 2 ,datë 20.07.2016 “Për kriteret teknike të klasifikimit të kullotave dhe livadheve,proçedurat për dhënin e tyre për kullotje e kositje Bari”

Bazuar në Ligjin nr 139/2015 “ Për vetëqeverisjen vendore”, neni 9 pika 1.2 a, c , neni 54 pika e(l) , është kompetencë e Këshillit të Bashkisë , dhënia me qira të tretëve të pronave të Bashkisë. udhëzimit të Ministrit të mjedisit nr. 2 ,date 20.07.2016 “Për kriteret teknike të klasifikimit të kullotave dhe livadheve,proçedurat për dhënin e tyre për kullotje e kositje Bari”,pika 8 është kopetence e këshillit të miratojë ndërtimet e përkohshme në funksion të kullotjes.

Sipërfaqja që planifikohet të jepet për ndërtime të përkohshme, është 300 m².

Në funksion të sipërfaqes që merret në përdorim, sipas VKM nr. 632, datë 11.06.2009 “Për percaktimin e tarifave në sektorin e kullotave” pika 1 germa c, sipas tipit të kullotës.

si me poshtë.

Nr.	Lloji i ndërtimit	Tipi i kullotës		Pyje që kulloten lekë/m ² /vit
		Dimërore lekë/m ² /vite	Verore lekë/m ² /vit	
1.	Qendër stani e rrethuar	50	50	50
2.	Qendër përpunim bulmeti	100	100	100
3.	Ngrehinë banimi për barinj	50	50	50
4.	Mullinj, magazina	100	100	100

Vlera totale e pagesës/vit sipas raportit teknik-ekonomik, është 15 000 (Pesëmbëdhjetë mijë)lekë

Bazuar në sa më sipër, propozojmë miratimin e sipërfaqes prej 250 m² për qendër stani e rrethuar dhe 50 m² ngrëhine banimi për barinje dhe stafin

Bashkëlidhur po ju dergojmë.

1.Dokumentacionin e plotë dhe hartën e ekonomisë.

Duke ju falënderuar, ju ftojme në miratimin e projekt vendimit.

Grupi i Punës


Ing.Mark Suli



Ing.Zeqir Ujka



Ing. Esmeraldo Harapi



Miratoi

Drejtori

Rrok Ftoni

